VII.2. Ky operator ekonomik, referuar DST, nuk plotëson kriterin e kapacitetit teknik për mos angazhimin e stafit, ku sipas DST kërkohej si më poshtë: 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinierët e kërkuar në pikë 2.3.3 për kualifikim janë të pa angazhuar në kontrata të tjera dhe, në rast se shpallen fitues për këto procedurë, do të qëndrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve. Shoqëria "Shansi Invets" shpk, sipas Buletinit Nr.17 datë 30.04.18: lidhet kontrata dt.06.04.2018; procedura: "Furnizim vendosje e Shunt reaktorit 400kV 120 MVar, Sistemit Total të monitorimit të tij, konfigurimin në sistemin SCADA, furnizimin dhe vendosjen e Traktit 400 kV në N/st Zemblak si dhe kryerja e të gjitha punimeve civile në lidhje me këtë projekt"; Vlera 651.771.013 lek me tvsh; me Autoritet Kontraktor Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.). Pra stafi dhe makinerite e deklaruara dhe të angazhuar në kontratën e sipërpermendur.

VII.3 Ky operator ekonomik, referuar DST, nuk plotëson kriterin e kapacitetit teknik për mos angazhimin të makinerive, ku sipas DST kërkohej si më poshtë: "2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik. Kërkohej të jenë në dispozicion këto mjete pune:

1. Eskavator me zinxhire - 1 cope
2. Eskavator me goma – 2 cope

3. Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton - 4 cope
4. Kamioncine (deri ne 6 ton) - 2 cope
5. Gurethyes, frontoje - 1 cope
6. Fabrike asfalti - 1 cope
7. Implant automatik betony - 1 cope
8. Autobitumatrice – 1 cope
9. Asfalto-shtruese – 1 cope
10. Greider - 1 cope
11. Rrul gome-hekur (kapaciteti jo me pak se 18 ton) - 2 cope
12. Rrul hekur-hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton) - 2 cope
13. Rrul asfalti me goma (Kapaciteti jo me pak se 13 ton) - 1 cope
14. Kompresor - 1 cope
15. Autobot uji - 1 cope
16. Vibrator - 2 cope
17. Autobetoniere - 3 cope
18. Freze asfalti - 1 cope

-Për pajisjet teknike, te cilat jane ne pronesi te subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe faturat tatimore të shitjes, ndersa kur jane te marra me qera duhet të paraqiten kontratat e qerases, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat qe nuk jane sipas formatit te miratuar me tvsh (faturat e biznesit te vogel) duhet te shoqerohen me kuponin tatimor.

*-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; - çertifikaten e kontrollit teknik; vertetimin e pageses per taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperme, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases. **Public Health Sector***

-Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimi, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperme, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases.

2.3.8 Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

Operatori ekonomik "Shansi Invest" shpk nuk e ka permbushur kriterin e DST pasi përvec se mendojme qe nuk i disponon disa makineri (p.sh, rul –gome ose eskavatoret me goma etj) makinerite e tera i ka te angazhuara ne kontraten me Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.). Pra per sa referuar me siper, per mosplotesim te kriterëve kapaciteve teknike te DST, pika 2.3.2.; 2.3.4; 2.3.7; 2.3.8 dhe në bazë të nenit 13, pika 3, germa “a” të LPP, kërkojmë skualifikimin e shoqerisë “Shansi Invest” sh.p.k. Bashkelidhur do të gjeni buletinin ku ky operator ka lidhur kontratën.

VIII. Kerkojme skualifikimin e operatorit ekonomik "Kupa" shpk, pasi ky operator eshte kualifikuar ne menyre te padrejte nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave ne shkelje te nenit 46, 53 të LPP dhe nenit 66 të VKM 914 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar, pasi:

VIII.1. Ky operator ekonomik referuar DST, nuk ploteson kriterin e kapacitetit teknik per punesimin e punonjesve, ku sipas DST dhe Sqarimit nr 1 te AK Fondi Shqipetar i Zhvillimit kerkohet si me poshtë: Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik, 2.3.2 "Te kete te punesuar minimalist 91 persona per periudhen (Shkurt 2018-Mars 2018), te vertetuar me: Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per periudhen (Shkurt 2018-Mars 2018), shoqeruar me formularet e listepagesave E-SIG. Pra nuk i ka 91 punonies per periudhen e kerkuar.

VIII.2. Ky operator ekonomik, referuar DST, nuk ploteson kriterin e kapacitetit teknik per mos angazhimin e stafit, ku sipas DST kerkohet si me poshte: 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne pike 2.3.3 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera dhe, ne rast se shpallen fitues per kete procedure, do te qendrojne ne objekt gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve. Shoqëria "Kupa" shpk, sipas Buletinit Nr.23 date 11.06.18: shpallur fitues; procedura: Loti 4 "Rikonstruksion I disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier"; Vlera 51.851.852 lek pa tvsh; me Autoritet Kontraktor Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pra stafi dhe makinerite e deklaruar dhe te angazhuar ne kontraten e siperpermendur.

VIII.3 Ky operator ekonomik, referuar DST, nuk ploteson kriterin e kapacitetit teknik per mos angazhimin te makinerive, ku sipas DST kerkohet si me poshte: "2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknik per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik. Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

1. Eskavator me zinxhire - 1 cope
2. Eskavator me goma – 2 cope
3. Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton - 4 cope
4. Kamioncine (deri ne 6 ton) - 2 cope
5. Gurethyes, frontoje - 1 cope
6. Fabrike asfalti - 1 cope
7. Implant automatik betony - 1 cope
8. Autobitumatrice – 1 cope
9. Asfalto-shtruese – 1 cope
10. Greider - 1 cope
11. Rrul gome-hekur (kapaciteti jo me pak se 18 ton) - 2 cope
12. Rrul hekur-hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton) - 2 cope
13. Rrul asfalti me goma (Kapaciteti jo me pak se 13 ton) - 1 cope
14. Kompresor - 1 cope
15. Autobot uji - 1 cope
16. Vibrator - 2 cope
17. Autobetoniere - 3 cope

18. Freze asfalti - 1 cope

-Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe faturat tatimore të shitjes, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqiten kontratat e qerave, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.

-Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; vertetimin e pagesës për taksat vjetore; siguracionin dhe fotot përkatëse; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave.

-Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e bërjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave.

2.3.8 Makineritë e mesipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këto të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mesipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Operatori ekonomik "Kupa" shpk nuk e ka përmbushur kriterin e DST pasi përveç se mendojmë që nuk i disponon disa makineri (p.sh, rul –gome ose eskavatorët me goma etj) makineritë e tëra i ka të angazhuara në kontratën me Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Pra për sa referuar me sipër, për mosplotësim të kriterëve kapacitëve teknike të DST, pika 2.3.2.; 2.3.4; 2.3.7; 2.3.8 dhe në bazë të nenit 13, pika 3, germa "a" të LPP, kërkojmë skualifikimin e shoqërisë "Kupa" sh.p.k. Bashkelidhur do të gjëni buletinën ku ky operator ka lidhur kontratën.

IX. Operatori ekonomik "Shkelqimi 07" sh.p.k., "Desaret Company" sh.p.k., "Caushi" sh.p.k., "Besta" sh.p.k., "Be-Is" sh.p.k., "SMO Union" sh.p.k., "Shansi Invest" sh.p.k., "Kupa" sh.p.k., referuar DST, nuk plotëson kriterin e kapacitetit ekonomik për paraqitjen e vërtetimeve, ku sipas DST kërkohet si më poshtë: Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar: "2.2.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitet 2016 dhe 2017". Pra asnjë nga operatorët ekonomik të sipërpërmendur nuk e ka përmbushur sic duhet këtë kriter. Për sa referuam më sipër kërkojmë nga ana juaj, zbatimin e ligjit, pra të kryhen verifikimet e nevojshme referuar kriterëve të vendosura në DST, pikat 2.2.4, 2.3.2, 2.3.4, 2.3.7, 2.3.8, për deklaratimet e bëra nga ana e kompanive të sipërpërmendura. Si dhe kërkojmë skualifikimin e tyre, për mosplotësim të kriterëve në DST. Si përfundim, kërkojmë anulimin e vendimit të KVO se Fondit Shqiptar të Zhvillimit, kërkojmë skualifikimin e shoqërive të sipërpërmendura "Shkelqimi 07" sh.p.k., "Desaret Company" sh.p.k., "Caushi" sh.p.k., "Besta" sh.p.k., "Be-Is" sh.p.k., "SMO Union" sh.p.k., "Shansi Invest" sh.p.k., "Kupa" sh.p.k., pasi ato kanë stafin dhe makineritë e angazhuara, pra nuk plotësojnë pikat 2.3.2, 2.3.4, 2.3.7, 2.3.8, 2.3.9, të DST dhe shpalljen fitues të shoqërisë "B-93" sh.p.k. pasi i plotëson të gjitha kërkesat e DST.

II.5. Në datën 20.06.2018, me shkresën nr. 857/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes duke mos e pranuar ofertën.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave, në lidhje me pretendimin e ankimesit të ofertës së shoqërisë "Shkelqimi 07" rezultoi anomalisht në ulet, verën se:

- Në datën 11.06.2018, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorin ekonomik "Shkelqimi 07" shpk të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditësh shpjegime për elemente të vecanta të ofertës.

- Në datën 13.06.2018, shoqëria "Shkelqimi 07" shpk ka paraqitur dokumentacionin për argumentimin e ofertës anomalisht në ulet.

- Autoriteti Kontraktor pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur për argumentimin e ofertës anomalisht në ulet, vendosi të konsiderojë të rregullt ofertën e shoqërisë "Shkelqimi 07" shpk në të gjitha elementet e saj.

Përsa me super, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave gjykon se Komisioni i Vleresimit të Ofertave, ka respektuar nenin 56 "Oferta anomalisht në ulet", të Ligjit Nr 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

1.3 Në lidhje me pretendimin se: oferta ekonomike e shoqërisë "Shkelqimi 07" sh.p.k nuk të krijon bindjen se është e rregullt në të gjithë elementet e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave verën se:

Ankimesi ngre pretendime a-priori duke mos parashtruar asnjë fakt apo dyshim të bazuar, që të provojë pretendimet e ngritura, sic përcaktohet në nenin 78, të V.K.M. Nr 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave gjykon se është detyrim i operatorit ekonomik ankimes që të provojë pretendimet e parashtruara për autoritetin kontraktor, duke paraqitur fakte apo argumenta bindëse, të cilat mbështesin ankesën, objekt shqyrtimi. Përsa me siper, pretendimi i parashtruar nga operatori ekonomik ankimes nuk qëndron.

Public Health Sector

I. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vleresimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Shkelqimi 07" shpk (operatori të kualifikuar me ofertën në ulet) me argumentin se: "Kjo shoqëri nuk ka 91 punonjës për periudhën e kërkuar "Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave bëri verifikimin përkatës në sistemin elektronik të prokurimit. Nga ky verifikim rezultoi se kjo shoqëri e plotëson dhe e tejkalon këto kërkesë për kualifikim.

III. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vleresimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Shkelqimi 07" shpk (operatori të kualifikuar me ofertën në ulet) me argumentin se: stafi dhe makineritë e deklaruara janë të angazhuara në kontratën me objekt Asfaltim i rrugëve të qytetit Roskovec Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesave verën se:

Fakti se një operator ekonomik është shpallur fitues edhe në kontratë / kontrata të tjerë nuk mund të shbejë deklaratën e administratorit të shoqërisë "se inxhinierët e kërkuar janë të pa angazhuar në kontratë të tjerë dhe atë pak të shërbejë automatikisht si shkak skualifikim, i pambështetur nga asnjë fakt ngre pretendime a-priori duke mos parashtruar asnjë fakt apo dyshim të bazuar,

sic percaktohet ne nenin 78, te VKM Nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e regullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave gjykon se eshte detyrim i operatori ekonomik ankimues qe te provoje pretendimet e parashtuara para Autoritetit Kontraktor , duke paraqitur fakte argumenta bindese, te cilat mbeshtesin ankesen, objekt shqyrtimi.

Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave gjykon se nje ankim, pa argumente te arsyeshme apo indicje te qarta, konsiderohet abuziv, pasi cenon efikasitetin e shpejtësinë e procedures se prokurimit publik .

Persa me siper, pretendimii parashtruar nga operatori ekonomik ankimues nuk qendron

IV. Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik ankimues per kundershhtimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave per kualifikimin e ofertes se operatori ekonomik "ShkëlqimiVII" shpk (operatori te kualifikuar me oferten me te ulet) me argumentin se : " nuk plotëson kapacitetin teknik per mos angazhimin e makinerive , pasi ne mendojme që nuk ka makineri dhe makinerite e tjera i ka te angazhuara ne kontraten me objekt Asfaltim i rrugeve te qytetit Roskovec', Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave veren se Ankimuesi ngre pretendime a-priori duke mos parashtruar asnje fakt apo dyshim te bazar, qe te provoje pretendimet e ngritura , sic percaktohet ne nenin 78 , te V.K. M Nr 914 date 29 . 12 . 2014 "Per miratimin e regullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave gjykon se eshte detyrim i operatori ekonomik qe te provoje pretendimet e parashtuara para Autoritetit Kontraktor , duke paraqitur fakte apo argumenta bindese, te cilat mbeshtesin ankesen, objekt shqyrtimi.

Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave gjykon se, pretendimi i ankimuesit qe midis te tjerave pretendon se : " ne mendojme qe nuk i disponon disa makinen . " eshte nje pretendim pa argumente te arsyeshme apo indicje te qarta , dhe konsiderohet abuziv , pasi cenon efikasitetin dhe shpejtesine e procedures se prokurimit publik.

Persa mësipër pretendimi i parashtruar nga operatori ekonomik ankimues nuk qëndron,

V . Lidhur me pretendimin e operatori ekonomik ankimues per kundershhtimin e vendimit te Komisionit te Vleresimit te Ofertave per kualifikimin e ofertes se operatori ekonomik Shkëlqimi 07 shpk (operatori te kualifikuar me oferten me te ulet) me argumentin se : nuk plogoson kriterin e kapacitetit ekonomik per paragatjen e nje deklarate me shkrim nga administratori se ka pagar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendor . "Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave veren se:

Ankimuesi ngre pretendime a-priori duke mos parashtruar asnje fakt apo dyshim te bazar, qe te provoje pretendimet e ngritura , sic percaktohet ne nenin 78 , te V.K. M Nr 914 date 29.12 . 2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" , i ndryshuar.

Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave gjykon se eshte detyrim i operatori ekonomik ankimues qe te provoje pretendimet e parashtuara para Autoritetit Kontraktor , duke paraqitur fakte apo argumenta bindese, te cilat mbeshtesin ankesen, objekt shqyrtimi.

Komisioni i ngarkuar per shqyrtimin e ankesave gjykon se nje ankim, pa argumente te arsyeshme apo indicje te qarta, konsiderohet abuziv, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtesine e procedures se prokurimit publik.

Persa me siper, pretendimi i parashtruar nga operatori ekonomik ankimues nuk qendron. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik ankimues B-93 " sh.p.k. mbi skualifikimin e shoqerive Desaret Company shpk, Caushi shpk, Besta" shpk , BE-IS" shpk , SMO Union sh.p.k. Shansi Invest" shpk, Kupa" shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Neni 63 , pika 1 . i Ligjit nr 9643 , date 20 . 11 . 2006 " Per prokurimin publik " (i ndryshuar) me titull: "Te drejtat e personi te interesuar", parashikon se: "Çdo person, qe ka ose ka pasur interes ne një procedure prokurimi dhe kur eshte dëmtuar ose rrezikohet te demtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marre ne kundërshtim me kete ligj), mund ta kundërshtoje vendimin.

Neni 63 , pika 1 , kerkon shprehimisht qe ankimuesi , jo vetem te kete interes , por edhe te jete demtuar realisht apo te rrezikohet te demtohet nga vendimi qe ka marre autoriteti kontraktor Ne rastin konkret, duke qene se operatori ekonomik " Shkelqimi 07 " sh p k (operator ekonomik qe ka oferte me te ulet ekonomike se ankimuesi) vijon te mbetet i kualifikuar , ne baze te arsyetimit te Komisionit te ngarkuar per shqyrtimin e ankesave , trajtimi i pretendimit te ankimuesit ne lidhje me operatoret e tjere ekonomike pjesemarrës ne procedure, nuk ka ndikim mbi fatin e cështjes, tashme qe nuk i eshte pranuar pretendimi mbi skualifikimin e shoqerise Shkelqimi 07.

Rrjedhimisht , ne kuptim te ligjit , interesi i tij i ligjshem , i drejtperdrejte e real , nuk ka sesi te demtohet nga sukcesi apo deshtimi i operatoreve te tjere ne ate procedure prokurimi, per arsye se oferta ekonomike e ankimuesit eshte me e lartë se oferta ekonomike e e shoqerise Shkelqimi 07" sh.p.k.

Për sa më sipër, pretendimet e ankimuesit per skualifikimin e operatoreve ekonomike Desaret Company " shpk , Caushi " shpk, Besta " shpk , BE-IS " shpk , SMO Union " shpk , Shansi Invest " shpk , Kupa " shpk nuk do te merren ne shqyrtim, pasi operatori ekonomik ankimues nuk legjitimohet.

Për sa më sipër, ne mbështetje te nenit 63, te Ligjit Nr , 9643 , date 20 . 11 . 2006 " Per Prokurimin Publik, te ndryshuar dhe nenit 78, pika 6, germa c, te V K M Nr 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar , Komisioni per shqyrtimin e ankeses, me unanimitet vendosi mospranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik "B – 93" sh.p.k.

II.6. Në datën 29.06.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë "Shkelqimi 07" sh.p.k., "Desaret Company" sh.p.k., "Çaushi" sh.p.k., "Besta" sh.p.k., "Be – Is" sh.p.k., "SMO Union" sh.p.k., "Shansi Invest" sh.p.k., "Kupa" sh.p.k.

II.7. Në datën 02.07.2018, nëpërmjet shkresës me nr.857/2 prot., datë 02.07.2018, me objekt: "Dërgim informacioni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentacioni dhe informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik "B - 93" sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] *Operatori ekonomik Kupa sh.p.k., nuk ploteson kriterin e kapacitetit teknik per punesimin e punonjesve, ku sipas DST dhe Sqarimit nr 1 te AK Fondi Shqiptar i Zhvillimit kerkohet si me poshtë: Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, 2.3 Kapaciteti teknik, 2.3.2 "Te kete te punesuar minimalist 91 persona per periudhen (Shkurt 2018-Mars 2018), te vertetuar me: Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per periudhen (Shkurt 2018-Mars 2018), shoqeruar me formularet e listepagesave E-SIG. Pra nuk i ka 91 punonies per periudhen e kerkuar [...]*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.2., nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *“Të ketë të punësuar minimalisht 91 persona për periudhën (Shkurt 2018 – Mars 2018), të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën (Shkurt 2018 – Mars 2018), shoqeruar me formularët e listepagesave E-SIG”*.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a., rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Kupa” sh.p.k. dhe shoqërisë “Liqeni VII” sh.a., nga ku shoqëria “Kupa” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 55% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria “Liqeni VII” sh.a. ka marrë përsipër të realizojë 45% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi (bashkëngjitur zërat e preventivit të ndarë për secilin operator).

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Kupa” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Konkretisht zërat e punimeve të preventivit referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së cituar më sipër janë ndarë si më poshtë vijon:

”Kupa” sh.p.k.

Punime gërmimi (gërmim dheu me ekskavator zinxhir..., gërmim dheu me ekskavator zinxhir..., transport dheu me auto (20%...);

Punime shtresash dhe sinjalistikë (shtresë cakëlli mbeturinë kave... (70%), mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës... (70%), shtresë stabilizanti... (70%), shtresë binderi me granil gur kave.... (30%), shtresë asfaltbetoni me granil guri kave... (30%), FV bordura betoni... (30%), ndërtim kunete..., gjeotekstil me gramaturë...,

Punime trotuari (trotuar..., mbushje me cakëll e gur gurore... (30%), FV bordura betoni...,

Punime për rrugë sekondare (gërmim dheu me ekskavator zinxhir., shtresë cakëlli mbeturine kave... (80%), shtresë stabilizanti..., shtresë binderi me granil gur kave... (20%), shtresë asfaltobetoni me granil gurë kave.... (20%), trotuar...,

Punime kullimi dhe vepra arti (pusetë b/a shiu..., tombino me tuba betoni..., tombino me tuba betoni..., mura b/a..., mbushje me argjilë pas mureve..., FV tuba të brinjëzuar ..., mbushje me rërë tubat..., struktura të holla monolite betoni..., struktura të holla monolite betoni..., FV hekur betoni..., parapet me tuba inoksi ngjyrë metalizato..., trotuar...,

Punime gjelbërimi (hapje gropa..., FV pleh organik..., vendosje mbështetëse..., ujitje fidanësh ..., FV fidanë pemë dekorative...)

”Liqeni VII” sh.a.

Punime gërmimi (transport dheu me auto...(80%);

Punime shtresash dhe sinjalistikë (shtresë cakëlli mbeturinë kave... ...(30%);, mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës... ...(30%);, shtresë stabilizanti... ...(30%);, shtresë binderi me granil gur kave.... ...(70%);, shtresë asfaltobetoni me granil guri kave... ...(70%);, FV bordura betoni... ...(70%), FV tabela trekëndore e vogël..., FV tabela të ndryshme rrugore..., vijëzim shirita gjatësor dhe anësor ..., bojë bikoponente...,

Punime trotuari (mbushje me cakëll e gur gurore... ...(70%);

Punime për rrugë sekondare (transport dheu me auto... ..., shtresë cakëlli mbeturine kave... ...(20%), skarifikim shtresë asfalti me makineri..., shtresë binderi me granil gur kave... ...(80%), shtresë asfaltobetoni me granil gurë kave.... (80%);

Punime ndriçimi (FV shtylla profili metalike për ndricim..., FV morsetë tokëzimi shtylle..., FV kabël..., FV kabëll..., FV tubo shllang..., FV elektroda togëzimi të zinguar..., FV tubo plastike ..., FV automat ..., blerje koka kabli..., FV kabëll..., FV pusetë plastike..., Panel ndricimi me rele...), Punime gjelbërimi (mbushje gropa me dhe+...).

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Kupa” sh.p.k. & ”Liqeni VII” sh.a. në përmbushje të kriterit të sipërcituar, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë me nr. T00315735, datë 23.05.2018, në emër të shoqërisë ”Liqeni VII” sh.a. ku konstatohen të dhëna për periudhën tatimore që nga muaji qershor i vitit 2015 deri në muajin prill të vitit 2018, nga ku konstatohet se për periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit Shkurt 2018 – Mars 2018, ky operator ekonomik ka përkatësisht 55 dhe 56 punonjës;
- Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë me nr. T00319623, datë 24.05.2018, në emër të shoqërisë ”Kupa” sh.p.k., ku konstatohen të dhëna për periudhën tatimore që nga muaji Qershor i vitit 2015 deri në muajin Prill të vitit 2018, nga ku konstatohet se për periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit Shkurt 2018 – Mars 2018, ky operator ekonomik ka përkatësisht 94 dhe 98 punonjës;

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përprjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Në Kreun VIII, neni 74, *“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”*, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

III.1.8. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.1.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë "Kupa" sh.p.k. & "Liqeni VII" sh.a. rezulton se secili nga anëtarët e këtij bashkimi e përmbush dhe e tejkalon numrin e punonjësve të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Kupa" sh.p.k. & "Liqeni VII" sh.a. është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga secili prej tyre plotësohet numri i punonjësve të kërkuar për periudhën e kërkuar në dokumentat e tenderit në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Kupa" sh.p.k. & "Liqeni VII" sh.a., është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik "B – 93" sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] *Operatori ekonomik Kupa shpk, referuar DST, nuk plotëson kriterin e kapacitetit teknik për mos angazhimin e stafit, ku sipas DST kerkohet si me poshte: 2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne pike 2.3.3 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera dhe, ne rast se shpallen fitues per kete procedure, do te qendrojne ne objekt gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve. Shoqëria "Kupa" shpk, sipas Buletinit Nr.23 date 11.06.18: shpallur fitues; procedura: Loti 4 "Rikonstruksion I disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier"; Vlera 51.851.852 lek pa tvsh; me Autoritet Kontraktor Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, Kapaciteti teknik, pika 2.3.4, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri:

“Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.3 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera dhe, ne rast se shpallen fitues per kete procedure, do te qendrojne ne objekt gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa ”a” te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a., rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Kupa” sh.p.k. dhe shoqërisë ”Liqeni VII” sh.a., nga ku shoqëria “Kupa” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 55% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria ”Liqeni VII” sh.a. ka marrë përsipër të realizojë 45% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi (bashkëngjitur zërat e preventivit të ndarë për secilin operator).

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Kupa” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Konkretisht zërat e punimeve të preventivit referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së cituar më sipër janë ndarë si më poshtë vijon:

”Kupa” sh.p.k.

Punime gjërmimi (gërmim dheu me ekskavator zinxhir..., gërmim dheu me ekskavator zinxhir..., transport dheu me auto (20%...);

Punime shtresash dhe sinjalistikë (shtresë cakëlli mbeturinë kave... (70%), mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës... (70%), shtresë stabilizanti... (70%), shtresë binderi me granil gur kave.... (30%), shtresë asfaltbetoni me granil guri kave... (30%), FV bordura betoni... (30%), ndërtim kunete..., gjeotekstil me gramaturë...,

Punime trotuari (trotuar..., mbushje me cakëll e gur gurore... (30%), FV bordura betoni...,

Punime për rrugë sekondare (gërmim dheu me ekskavator zinxhir..., shtresë cakëlli mbeturinë kave... (80%), shtresë stabilizanti..., shtresë binderi me granil gur kave... (20%), shtresë asfaltbetoni me granil gurë kave.... (20%), trotuar...,

Punime kullimi dhe vepra arti (pusetë b/a shiu..., tombino me tuba betoni..., tombino me tuba betoni..., mura b/a..., mbushje me argjilë pas mureve..., FV tuba të brinjëzuar ..., mbushje me rërë tubat..., struktura të holla monolite betoni..., struktura të holla monolite betoni..., FV hekur betoni..., parapet me tuba inoksi ngjyrë metalizato..., trotuar...,

Punime gjelbërimi (hapje gropa..., FV pleh organik..., vendosje mbështetëse..., ujitje fidanësh ..., FV fidanë pemë dekorative...)

”Liqeni VII” sh.a.

Punime gjërmimi (transport dheu me auto...(80%);

Punime shtresash dhe sinjalistikë (shtresë cakëlli mbeturinë kave... ...(30%);, mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës... ...(30%);, shtresë stabilizanti... ...(30%);, shtresë binderi me granil gur kave.... ...(70%);, shtresë asfaltbetoni me granil guri kave... ...(70%);, FV bordura betoni...

...(70%), FV tabela trekëndore e vogël..., FV tabela të ndryshme rrugore..., vijëzim shirita gjatësor dhe anësor, bojë bikoponente...,

Punime trotuari (mbushje me cakëll e gur gurore... ..(70%);

Punime për rrugë sekondare (transport dheu me auto... .., shtresë cakëlli mbeturine kave... ..(20%), skarifikim shtresë asfalti me makineri..., shtresë binderi me granil gur kave... ..(80%), shtresë asfaltobetoni me granil gurë kave.... (80%);

Punime ndriçimi (FV shtylla profili metalike për ndricim..., FV morsetë tokëzimi shtylle..., FV kabël..., FV kabëll..., FV tubo shllang..., FV elektroda togëzimi të zinguar..., FV tubo plastike ..., FV automat ..., blerje koka kabli..., FV kabëll..., FV pusëtë plastike..., Panel ndricimi me rele...),

Punime gjelbërimi (mbushje gropa me dhe+...)

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Kupa" sh.p.k. & "Liqeni VII" sh.a. në përmbushje të kriterit të sipërcituar, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Deklaratë për angazhimin e inxhinierëve në objekt nga shoqëria "Liqeni VII" sh.a. sipas së cilës deklarohet se: *"[...] Inxhinierët e kërkuar në pikën 2.3.3. për kualifikim në tenderin me objekt "Rikonstruksion i Rrugës Ramize Gjebrea Faza 2 (Lidhja e rrugës së Pyllit të Sodës me rrugën Transballkanike dhe Autostradën) [...] janë të paangazhuar në kontrata të tjera dhe nëse shpallemi fitues do të qëndrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve, deri në përfundim të plotë të tyre. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën, të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë, sipas adresës së shoqërisë dhe sipas dokumentacionit të paraqitur në tender".*
- Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës "Kupa" sh.p.k. në procedurën e prokurimit [...], sipas së cilës deklarohet se: *"[...] Deklarojmë se inxhinierët e kërkuar në pikën 2.3.3. për kualifikim janë të paangazhuar në kontrata të tjera dhe nëse shpallemi fitues për këtë procedurë do të qëndrojmë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën, të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "Për prokurimin publik".*

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese." Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".*

III.2.5. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

III.2.6. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë paisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si edhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe për të krijuar një panoramë të qartë mbi stafin, marrëdhëniet e punës dhe vijueshmërinë e tyre.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar sipas pikës 2.3.3. të dokumentave të tenderit (inxhinier ndërtimi, inxhinier mekanik, inxhinier hidroteknik, inxhinier elektrik, inxhinier mjedisi, inxhinier gjeolog, inxhinier gjeodet) të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a., Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, ky i fundit, në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për stafin e deklaruar, ka paraqitur deklaratat përkatëse sipas këtyre përcaktimeve të bëra përkatësisht në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, në pikën 2.3.4..

Konkretisht, operatorët ekonomikë “Kupa” sh.p.k. dhe “Liqeni VII” sh.a., si anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili ka paraqitur Deklaratën sipas së cilës deklarohet se stafi i secilës shoqëri nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, si edhe i rezervojnë të drejtën autoritetit kontraktor që të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Sqarojmë se referuar kriterëve për kualifikim të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, secili operator ekonomik anëtar i bashkimit të operatorëve, nëpërmjet vetëdeklarimit të bërë ka deklaruar se stafi i tij nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, duke marrë përsipër edhe përgjegjësinë e tij për këtë deklaram. Ashtu siç edhe autoriteti kontraktor informon, sqarojmë se plotësimi i kësaj deklarate është përgjegjësi e operatorit ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike, që në këtë rast është paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a.

III.2.8. Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se: *“Shoqëria "Kupa" shpk, sipas Buletinit Nr.23 date 11.06.18: shpallur fitues; procedura: Loti 4 “Rikonstruksion I disa QSH-ve në qarqet Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier”; Vlera 51.851.852 lek pa tvsh; me Autoritet Kontraktor Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e vetë operatorit ekonomik ankimues nuk jepen fakte e prova mbi pretendimet që ngre, por thjesht citon se *“është shpallur fitues në procedurën[...]”*, duke mos paraqitur fakte e prova në lidhje me faktin e shpalljes fitues të operatorit ekonomik “Kupa” sh.p.k. për procedurën

me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke mos argumentuar asgjë në lidhje me stafin e angazhuar, por thjesht duke cituar që është shpallur fitues në këtë procedurë dhe për këtë arsye e ka stafin të angazhuar në kontrata të tjera.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se në lidhje me dyshimet e ngritura nga ana e operatorit ekonomik ankimues, përse i përket deklaratës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a., në lidhje me stafin e angazhuar, ankimuesi mund t’i drejtohet organeve përkatëse për të verifikuar deklaratimet e bëra nga ky operator ekonomik.

Rrjedhimisht, sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a. ka paraqitur dokumentacion sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se [...] *Operatori ekonomik Kupa shpk, nuk plotëson kriterin për mosangazhimin e mjeteve[...] si edhe nuk i disponon disa nga makineritë (psh rul gome – gome, ose ekskavatorët me goma etj) por makineritë e tjera i ka të angazhuara në kontratat me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, Kapaciteti teknik, pika 2.3.7, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontrates. Për këto duhet të paraqesë deshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.*

Kerkohen të jene në dispozicion keto mjete pune:

- *Eskavator me zinxhire – 1 copë*
- *Eskavator me goma – 2 cope*
- *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton – 4 copë*
- *Kamionçinë (deri në 6 ton) – 2 copë*
- *Gurëthyes, frontoje – 1 copë*
- ***Fabrikë asfalti – 1 copë***
- ***Impiant automatik betoni – 1 copë***
- *Autobitumatriçe – 1 copë*
- *Asfalto-shtruese – 1 copë*
- *Greidër – 1 copë*
- *Rrul gome – hekur (kapaciteti jo me pak se 18 ton) – 2 copë*
- *Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo me pak se 8 ton) – 2 copë*
- *Rrul asfalti me goma (Kapaciteti jo me pak se 13 ton) – 1 copë*
- *Kompresor – 1 copë*
- *Autobot uji – 1 copë*
- *Vibrator – 2 copë*

- *Autobetoniere – 3 copë*
- *Freze asfalti – 1 copë*
- *Për pajisjet teknike, te cilat jane ne pronesi te subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe faturat tatimore të shitjes, ndersa kur jane te marra me qera duhet të paraqiten kontratat e qerases, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat qe nuk jane sipas formatit te miratuar me tvsh (faturat e biznesit te vogel) duhet te shoqerohen me kuponin tatimor.*
- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; vertetimin e pageses per taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases.*
- *Për pajisjet teknike, te cilat jane ne pronesi te subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe faturat tatimore të shitjes, ndersa kur jane te marra me qera duhet të paraqiten kontratat e qerases, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat qe nuk jane sipas formatit te miratuar me tvsh (faturat e biznesit te vogel) duhet te shoqerohen me kuponin tatimor.*
- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; vertetimin e pageses per taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerases”*

Në pikën 2.3.8 të po kësaj Shtojce (12) autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

”Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa ”a” te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Per Prokurimin Publik”.

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a., rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërisë “Kupa” sh.p.k. dhe shoqërisë ”Liqeni VII” sh.a., nga ku shoqëria “Kupa” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 55% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe

shoqëria "Liqeni VII" sh.a. ka marrë përsipër të realizojë 45% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi (bashkëngjitur zërat e preventivit të ndarë për secilin operator). Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Kupa" sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë. Konkretisht zërat e punimeve të preventivit referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së cituar më sipër janë ndarë si më poshtë vijon:

"Kupa" sh.p.k.

Punime gërmimi (gërmim dheu me ekskavator zinxhir..., gërmim dheu me ekskavator zinxhir..., transport dheu me auto (20%...);

Punime shtresash dhe sinjalistikë (shtresë cakëlli mbeturinë kave... (70%), mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës... (70%), shtresë stabilizanti... (70%), shtresë binderi me granil gur kave... (30%), shtresë asfaltbetoni me granil guri kave... (30%), FV bordura betoni... (30%), ndërtim kunete..., gjeotekstil me gramaturë...,

Punime trotuari (trotuar..., mbushje me cakëll e gur gurore... (30%), FV bordura betoni...,

Punime për rrugë sekondare (gërmim dheu me ekskavator zinxhir..., shtresë cakëlli mbeturinë kave... (80%), shtresë stabilizanti..., shtresë binderi me granil gur kave... (20%), shtresë asfaltbetoni me granil gurë kave... (20%), trotuar...,

Punime kullimi dhe vepra arti (pusetë b/a shiu..., tombino me tuba betoni..., tombino me tuba betoni..., mura b/a..., mbushje me argjilë pas mureve..., FV tuba të brinjëzuar ..., mbushje me rërë tubat..., struktura të holla monolite betoni..., struktura të holla monolite betoni..., FV hekur betoni..., parapet me tuba inoksi ngjyrë metalizato..., trotuar...,

Punime gjelbërimi (hapje gropa..., FV pleh organik..., vendosje mbështetëse..., ujitje fidanësh ..., FV fidanë pemë dekorative...)

Public Health Sector

"Liqeni VII" sh.a.

Punime gërmimi (transport dheu me auto...(80%);

Punime shtresash dhe sinjalistikë (shtresë cakëlli mbeturinë kave... ...(30%);, mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës... ...(30%);, shtresë stabilizanti... ...(30%);, shtresë binderi me granil gur kave... ...(70%);, shtresë asfaltbetoni me granil guri kave... ...(70%);, FV bordura betoni... ...(70%), FV tabela trekëndore e vogël..., FV tabela të ndryshme rrugore..., vijëzim shirita gjatësor dhe anësor ..., bojë bikoponente...,

Punime trotuari (mbushje me cakëll e gur gurore... ...(70%);

Punime për rrugë sekondare (transport dheu me auto... ..., shtresë cakëlli mbeturinë kave... ...(20%), skarifikim shtresë asfalti me makineri..., shtresë binderi me granil gur kave... ...(80%), shtresë asfaltbetoni me granil gurë kave... (80%);

Punime ndriçimi (FV shtylla profili metalike për ndricim..., FV morsetë tokëzimi shtylle..., FV kabël..., FV kabëll..., FV tubo shllang..., FV elektroda togëzimi të zinguar..., FV tubo plastike ..., FV automat ..., blerje koka kabli..., FV kabëll..., FV pusetë plastike..., Panel ndricimi me rele...),

Punime gjelbërimi (mbushje gropa me dhe+...)

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Kupa" sh.p.k. & "Liqeni VII" sh.a. në përmbushje të kriterit të sipërcituar, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

"Liqeni VII" sh.a.

- Shtojca 10 Mbi disponimin e makinerive, ku deklarohen mjetet ndër të tjera: ekskavator me goma; rrul goma – hekur[...];
- Deklaratë nëpërmjet të cilës deklarohet se: [...] mjetet, makineritë dhe të gjitha pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës 10[...], nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe në asnjë rast nuk do të jenë të angazhuara në objekte të tjera deri në përfundim të kësaj kontrate.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën, të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë, vendndodhjen e Mjeteve sipas adresës së shoqërisë në Lagjen nr. 14, Shkozet, Durrës dhe sipas shtojcës së paraqitur në tender".

"Kupa" sh.p.k.

- Shtojca 10 Mbi disponimin e makinerive, ku deklarohen mjetet ndër të tjera: Rrul goma hekur; rrul asfalti me goma; rrul gomë hekuar; ekskavator me zinxhir[...];
- Deklaratë nëpërmjet të cilës deklarohet se: [...] makineritë e deklaruara nga ne sipas Shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën, të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar "Për prokurimin publik".

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese." Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".

III.3.5. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

III.3.6. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret e kualifikimit i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe të kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se

zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë paisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si edhe personelin e nevojshëm, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit, për të krijuar bindjen se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit si edhe për të krijuar një panoramë të qartë mbi stafin, marrëdhëniet e punës dhe vijueshmërinë e tyre.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të deklarojnë të gjitha mjetet që disponojnë për këtë procedurë prokurimi, nëpërmjet dorëzimit të shtojcës përkatëse të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit, si edhe duhet të deklarojnë se të gjitha këto mjete nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, nëpërmjet paraqitjes së deklaratës përkatëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a., Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, ky i fundit, në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për mjetet, ka paraqitur deklaratat përkatëse sipas këtyre përcaktimeve të bëra përkatësisht në shtojcën 12 të dokumentave të tenderit, në pikën 2.3.7. dhe 2.3.8.

Konkretisht, operatorët ekonomikë “Kupa” sh.p.k. dhe “Liqeni VII” sh.a., si anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili ka paraqitur Deklaratën sipas së cilës deklarohet se mjetet e secilës shoqëri nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera, si edhe i rezervojnë të drejtën autoritetit kontraktor që të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Sqarojmë se referuar kriterëve për kualifikim të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, secili operator ekonomik anëtar i bashkimit të operatorëve, nëpërmjet vetëdeklarimit të bërë ka deklaruar se mjetet dhe makineritë nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera, duke marrë përsipër edhe përgjegjësinë e tij për këtë deklaram. Ashtu siç edhe autoriteti kontraktor informon, sqarojmë se plotësimi i kësaj deklaratë është përgjegjësi e operatorit ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike, që në këtë rast është paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a.

III.3.8. Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se: *“Shoqëria "Kupa" shpk, sipas Buletinit Nr.23 date 11.06.18: shpallur fitues; procedura: Loti 4 “Rikonstruksion I disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier”; Vlera 51.851.852 lek pa tvsh; me Autoritet Kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e vetë operatorit ekonomik ankimues nuk jepen fakte e prova mbi pretendimet që ngre, por thjesht citon se *“është shpallur fitues në procedurën[...]”*, duke mos paraqitur fakte e prova në lidhje me faktin e shpalljes fitues të operatorit ekonomik “Kupa” sh.p.k. për procedurën me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke mos argumentuar asgjë në lidhje me mjetet e angazhuara, por thjesht duke cituar që është shpallur fitues në këtë procedurë dhe për këtë arsye i ka mjetet të angazhuara në kontrata të tjera.

Rrjedhimisht, sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a. ka paraqitur dokumentacion sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

III.3.9. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues përsa i përket mjetit rrul gomë-gomë, sqarohet se në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar ndonjë kriter i tillë “mjet rrul gomë – gomë”, por ka kërkuar shprehimisht mjet rrul gomë – hekur, rrul hekur – hekur, rrul asfalti me goma. Në këtë rast, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka detyrimin të vlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura në dokumentat e procedurës së prokurimit dhe jo të gjykojë mbi kriteret të pavendosura.

Në lidhje me mjetin ekskavator me goma, sipas dokumentacionit të paraqitur dhe të cituar më sipër, në varësi edhe të zërave të preventivit të marra përsipër nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, bashkimi i operatorëve ekonomikë e përmbush kriterin në lidhje me këtë mjet.

III.3.10. Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik “*mjeteve etj*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në ankesën drejtuar pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashton fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* në lidhje me mjetet në përgjithësi.

III.3.11. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “*elementet e domosdoshëm të ankesës*” sipas përcaktimeve të nenit 20, “*Forma dhe përmbajtja e ankesës*”, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”*

III.3.12. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë.

Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.3.13. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të

këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.3.14. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësi të procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

III.3.15. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.3.16. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Public Health Sector

Rrjedhimisht pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “B - 93” sh.p.k. nuk merren shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “B – 93” sh.p.k. ndaj vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Shkëlqimi 07” sh.p.k., “Desaret Company” sh.p.k., “Çaushi” sh.p.k., “Besta” sh.p.k., “Be – Is” sh.p.k., “SMO Union” sh.p.k., “Shansi Invest” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kupa” sh.p.k. & “Liqeni VII” sh.a. përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimesit në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Shkëlqimi 07” sh.p.k., “Desaret Company” sh.p.k., “Çaushi” sh.p.k., “Besta” sh.p.k., “Be – Is” sh.p.k., “SMO Union” sh.p.k., “Shansi Invest” sh.p.k., nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qenë se, në renditjen përfundimtare,

para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar, me ofertë ekonomike në vlerë më të vogël se e ajo e operatorit ekonomik ankimues.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “B - 93” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-67597-05-08-2018, me objekt “Rikonstruksioni i Rrugës Ramize Gjebrea, Faza 2 (Lidhja e rrugës së Pyllit të Sodës me rrugën Transballkanike dhe Autostradën)”, me fond limit 130.894.667 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.06.2018, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Banka Botërore).
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1203 Protokoll

Datë 29.06.2018

Public Health Sector

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha